

Vendim nr. 94 datë 03.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 03.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GËZIM VASI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 222 (21-2017-1145), datë 20.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. 20-2017-816/208, datë 12.10.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2023-1689, datë 26.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 2, 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr.8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 05.10.2014 shërbimet e Drejtorisë së Policisë Vendore Gjirokastrë janë njoftuar se në Shtëpëz të Poshtëm, Gjirokastrë 5 persona të maskuar kanë vjedhur me dhunë teqenë e Baba Hasanit dhe banesën e shtetasit A.S. që ndodhet brenda oborrit të teqesë, i cili shërben edhe si babai i teqesë. Personat e maskuar, pasi kanë ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj familjarëve të shtetasit A.S., kanë përvetësuar sende me vlerë dhe më pas janë larguar në drejtim të paditur.

2. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për materialet e referuara nga policia është bërë regjistrimi i procedimit penal, si dhe janë kryer veprimet e para hetimore, duke përcaktuar edhe disa nga personat e dyshuar për këtë veprë penale.

3. Shtetasi Gëzim Vasi (*kërkuesi*), është një nga personat e dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit A.S. dhe familjarëve të tij. Në datën 04.11.2014 kërkuesi është vetëdorëzuar në polici ku ka pranuar se ishte autor i një vjedhjeje tjetër me dhunë ndaj shtetasit A.G. (proces që nuk është objekt i ankimit kushtetues individual), por nuk ka pranuar autorësinë për vjedhjen me dhunë të teqesë dhe të familjes së shtetasit A.S.

4. Në kuadër të këtij procedimi penal rezulton, gjithashtu, se është kryer ndalimi edhe i shtetasit A.B. i dyshuar si bashkëpunëtor në të dyja ngjarjet e mësipërme kriminale. Në vijim, të dy të pandehurit janë akuzuar se kanë kryer veprën penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal.

5. Në datën 07.11.2014, brenda automjetit të policisë nga oficerët e Policisë Gjyqësore është realizuar përgjimi ambiantal i këtyre dy të pandehurve, i cili është vlerësuar i ligjshëm nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Ky përgjim rezulton të ketë shërbyer si provë jo vetëm në procesin penal objekt të ankimit kushtetues individual, por edhe në procesin penal ndaj këtyre shtetasve për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit A.G.

6. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pasi ka mbyllur hetimet dhe ka veçuar çështjen për tre autorët e pazbuluar të ngjarjes, ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkuesit dhe shtetasit A.B., duke kërkuar dënimin e tyre me 15 vjet burgim secili, pasi nga tërësia e provave të paraqitura vërtetohet fajësia në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 222 (21-2017-1145), datë 20.07.2017, të zhvilluar sipas ritit të gjykimit të zakonshëm, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, nga provat e paraqitura ka rezultuar e provuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen. Ndaj këtij vendimi, kërkuesi ka paraqitur ankim, duke pretenduar se ai ishte i pabazuar në ligj dhe në prova. Kërkuesi ka kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor lidhur me provën e përgjimit ambiental, me argumentin se ajo nuk dëgjohej mirë, si dhe përfundimisht prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes, pasi nuk vërtetohej fajësia e tij.

8. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2017-816/208, datë 12.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Sipas gjykatës, shkaqet e parashtruara në ankim nga kërkuesi nuk janë të bazuara në ligj dhe në prova. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1689, datë 26.10.2023, pasi ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka zbatuar drejt ligjin, si dhe kërkuesi nuk ka paraqitur shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

10. Në datën 21.03.2024 kërkuesi, përmes shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar :

11.1. E drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

11.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtarja M.I., e cila ka marrë pjesë në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nuk duhej ta gjykonte këtë çështje për shkak se ka dhënë mendim në çështjen tjetër penale në ngarkim të kërkuesit për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit A.G., ku janë shqyrtuar të njëjtat prova, duke treguar në këtë mënyrë njëanshmëri në gjykim. Kjo shkelje, megjithëse është ngritur nga kërkuesi gjatë gjykimit në apel, nuk është korrigjuar as nga ajo gjykatë, as nga Gjykata e Lartë.

- 11.1.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi gjykatat e të tria shkallëve të gjyimit kanë vendosur dënimin e kërkuarit mbi bazën e provave të papërdorshme dhe të mbledhura në mënyrë të paligjshme, siç janë CD-ja e përgjimit ambiantal dhe deklarimet e shtetases së mitur E.S.
- 11.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjatë procesit gjyqësor nuk i janë vënë në dispozicion as dosja hetimore, as dëshmia e së miturës E.S., duke mos e lejuar të debatojë dhe të mbrohet në lidhje me to. Prova kryesore, CD-ja e përgjimit ambiantal, nuk është siguruar në formën e duhur, pasi duheshin marrë dhe shqyrtuar edhe prova të tjera lidhur me çështjen.
- 11.1.4. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi Gjykata e Lartë kishte detyrimin për të njoftuar kërkuarin për gjykimin e çështjes së tij në dhomën e këshillimit. Gjykata e Lartë, gjithashtu, duhej t'i vinte në dispozicion kërkuarit aktet e kërkuara prej tij në mënyrë që t'i jepte mundësi të mbrohej.
- 11.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi si Gjykata e Apelit Gjjirokastër, ashtu edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kanë ndrequr të metat e konstatuara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjjirokastër, e cila e ka filluar dhe përmbyllur procesin me bindjen se kërkuari ishte fajtor. Ky fakt vërtetohet nga mënyra se si janë çmuar provat nga ajo gjykatë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht,

për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

14. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

15. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur* pasi gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit kanë vendosur dënimin e kërkuesit mbi bazën e provave të papërdorshme dhe të mbledhura në mënyrë të paligjshme, siç janë CD-ja e përgjimit ambiental dhe deklaratimet e shtetases së mitur E.S.

17. Kolegji, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, si dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, konstaton se kërkuesi ka kërkuar përpara gjykatave të zakonshme ekspertimin e CD-së së përgjimit ambiental, me pretendimin se për shkak të zhurmave ajo nuk dëgjohej mirë, ndërkohë që organi i akuzës rezulton të ketë vënë në dispozicion të gjykatës dhe të kërkuesit transkriptimin e përgjimit. Kjo kërkesë është rrëzuar, pasi gjykata ka vlerësuar se CD-ja është e kuptueshme dhe ajo si provë është marrë e transkriptuar, referuar kërkesave të KPP-së. Lidhur me këtë provë nuk rezulton se nga ana e kërkuesit të jetë kërkuar pavlefshmëria dhe papërdorshmëria e saj. Edhe për sa u takon deklaratimeve të shtetases së mitur E.S., pretendimet për papërdorshmërinë dhe pavlefshmërinë e kësaj prove janë ngritur për herë të

parë në ankimin kushtetues individual dhe nuk janë pretenduar asnjëherë përpara gjykatave të zakonshme.

18. Kolegji vëren, gjithashtu, se pretendimet në mbështetje të *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, konkretisht se kërkuesit nuk i janë vënë në dispozicion gjatë procesit gjyqësor dosja hetimore dhe dëshmia e së miturës E.S., duke mos e lejuar të debatojë dhe të mbrohet dhe se prova kryesore, CD-ja e përgjimit ambiental nuk është siguruar në formën e duhur, si dhe duheshin marrë dhe shqyrtuar edhe prova të tjera lidhur me çështjen, nuk janë ngritur më parë prej tij në procesin gjyqësor të kundërshtuar, por janë ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual.

19. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në lidhje me pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, për rrjedhojë ato nuk mund të merren në shqyrtim.

20. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, konkretisht ato për cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim, së drejtës për t'u njoftuar dhe parimit të prezumimit të pafajësisë*, Kolegji konstaton se kërkuesi i ka parashtruar ato në formë dhe përmbajtje në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, në lidhje me këto pretendime konsiderohet se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

21. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 21.03.2024, kurse vendimi gjyqësor më i fundit i kundërshtuar nga

kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 26.10.2023. Për qëllime të këtij shqyrtimi, i është kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 11.04.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi nr. 00-2023-1689, datë 26.10.2023 i Kolegjit Penal është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 16.02.2024, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët, për rrjedhojë kërkesa konsiderohet e paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

23. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi si Gjykata e Apelit Gjirokastër, ashtu edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kanë ndrequr të metat e konstatuara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila e ka filluar dhe përmbyllur procesin me bindjen se kërkuesi ishte fajtor, fakt ky që, sipas tij, vërtetohet nga mënyra se si janë çmuar provat nga ajo gjykatë.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kolegji, bazuar në natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuesit, vlerëson se ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe shqyrtimit të provave, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues.

26. Kolegji vëren, gjithashtu, se në këndvështrim të së drejtës për t’u njoftuar, kërkuesi ka pretenduar edhe se Gjykata e Lartë nuk i ka vendosur në dispozicion atij dosjen gjyqësore me qëllim mbrojtjen në gjykimin që pritej të zhvillohej në atë gjykatë. Megjithatë, ky pretendim për nga natyra e tij do të trajtohet në këndvështrim të *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*.

27. Bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se kërkuesi ka paraqitur disa kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë për vënien në dispozicion të dosjes së tij gjyqësore. Po kështu, ai ka paraqitur ankesa ndaj Gjykatës së Lartë në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ). Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 2196/1 prot., datë 04.05.2023, ka njoftuar kërkuesin se për tërheqjen e akteve duhej që pranë asaj gjykate të paraqitej një përfaqësues me prokurë i kërkuesit për të identifikuar aktet të cilat kërkoheshin dhe për të paguar tarifën gjyqësore. Po

të njëjtën përgjigje i ka kthyer edhe KLGJ-ja kërkuesit me shkresat nr. 2749/3 prot., datë 23.05.2023 dhe nr. 3646/1 prot., datë 30.06.2023. Bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson se kërkuesit i është dhënë mundësia të njihet me aktet e dosjes së tij nëpërmjet një përfaqësuesi me prokurë. Për më tepër kërkuesi nuk ka evidentuar se cilat janë ato akte të dosjes së tij gjyqësore me të cilat ai nuk ka pasur mundësinë të njihet gjatë procesit në gjykatat e faktit dhe që ia kanë bërë të vështirë ose të pamundur mbrojtjen në Gjykatën e Lartë, e cila, për më tepër, është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të tij. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

28. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, konkretisht për cenimin e *parimit të paanshmërisë* në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për shkak të pjesëmarrjes në gjykim të një gjyqtareje që ka marrë pjesë në procesin tjetër penal kundër kërkuesit, si dhe për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin për gjykimin në dhomën e këshillimit, Kolegji vlerëson se ato *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të shqyrtohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

29. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarja M.I., e cila ka marrë pjesë në gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nuk duhej ta gjykonte këtë çështje për shkak se ka dhënë mendim në çështjen tjetër penale në ngarkim të kërkuesit për veprën penale “Vjedhja me dhunë” të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit A.G., ku janë shqyrtuar të njëjtat prova, duke treguar në këtë mënyrë njëanshmëri në gjykim. Kjo shkelje, megjithëse është ngritur nga kërkuesi gjatë gjyqimit në apel, nuk është korrigjuar as nga ajo gjykatë, as nga Gjykata e Lartë.

30. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr.19, datë 04.04.2023; nr.70, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij si i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe *super partes* (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 48, datë 22.07.2016; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimin nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Lidhur me rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim paanshmërinë, për sa kohë që vlerësimet që ka bërë te procesi tjetër penal, (ai në dëm të shtetasit A.G.) lidhur me provën e përgjimit ambiental, të kenë shërbyer për vlerësimin e fajësisë së kërkuesit edhe në procesin e kundërshtuar me këtë ankim kushtetues individual. Gjyqtarja M.I. nuk rezulton të jetë shprehur në një shkallë tjetër të procedimit dhe pjesëmarrja e saj në një tjetër çështje penale, me të njëjtët të pandehur, nuk përbën papajtueshmëri, pasi prova “përgjim ambiental”, e pretenduar nga të gjykuarit se është përdorur në të dyja gjykimet, është çmuar në raport me provat e tjera të secilit gjykim.

33. Kolegji vëren, gjithashtu, se pretendimit të kërkuesit i është dhënë përgjigje ligjore edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Ajo gjykatë, si gjykatë e ligjit, ka interpretuar faktin nëse rasti konkret bën pjesë në përcaktimet e neneve 15 e vijues të KPP-së ose jo.

34. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka paraqitur fakte bindëse për të argumentuar cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme, për sa i takon testit objektiv. Vendimi i Gjykatës së Lartë, në këtë rast, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm për cenimin e paanshmërisë nga ana e gjyqtarës, për rrjedhojë ky pretendim rezulton haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar

35. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për shqyrtimin e çështjes së tij në dhomën e këshillimit edhe pse kishte detyrimin në këtë drejtim.

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për gjykimin dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Sipas Gjykatës, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të

drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 13, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 21.11.2017, ndërsa shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është caktuar të zhvillohet në datën 19.09.2023. Gjithashtu, rezulton se në datën 18.07.2023, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është shpallur shqyrtimi i çështjeve në dhomën e këshillimit për datën 19.09.2023, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit, si dhe përbërja e trupit gjykues.

39. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka publikuar në faqen elektronike të saj njoftimin për datën, orën dhe trupin gjykues të caktuar për shqyrtimin e rekursit. Gjithashtu, konstatohet se kërkuesi ka qenë i përfaqësuar me avokat në këtë çështje dhe është ai që e ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekursin e paraqitur përpara saj. Në këtë mënyrë, kërkuesi, nëpërmjet avokatit të tij, ka pasur mundësinë dhe kohën e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tij procedurale. Për më tepër, kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim në lidhje me pamundësinë e tij ose të përfaqësuesit ligjor për t'u njohur me të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe as në lidhje me vënien në dispozicion të adresës së e-mail-it. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar është haptazi i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.